

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Valdete Daka dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit S.K., nga fshati Novolan, komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.11/2016 datë 4.11.2016 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së apelit të Kosovës, PA.1.nr.1595/2016 datë 21.2.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23 janar 2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit S.K., e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.11/2016 datë 4.11.2016 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së apelit të Kosovës, PA.1.nr.1595/2016 datë 21.2.2017.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega në Vushtrri – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, P.nr.11/2016 datë 4.11.2016, i dënuari S.K., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPK dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, të cilin dënim është i obliguar që ta vuajë pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, ndërsa konform nenit 69 të KPK të dënuarit i është shqiptuar edhe dënim plotësues marrja e patentë shoferit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti pas mbajtjes së dënimit. Është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 € dhe në emër të dy ekspertizave të komunikacionit shumën prej 194 € si dhe për super ekspertizë shumën prej 368 € e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë

së aktgjykimit. Përfaqësuesi i të dëmtuarës për realizimin e kërkesë pasurore-juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Në procedurën ankimore në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA.1.nr.1595/2016 datë 21.2.2017, me aprovimin e ankesës së mbrojtëses të të dënuarit S.K., është ndryshuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë vetëm përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të dënuarin S.K. për veprën për të cilën është shpallur fajtor e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim do ta vuajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtyre aktgjykimeve mbrojtësja e të dënuarit av. F.B., ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që të njëjtat të anulohen dhe çështja t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.57/2017 datë 14.4.2017, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me neni 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

Kërkesa nuk është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen të ligjshmërisë mbrojtësja e të dënuarit, av. F.B., konsideron se aktgjykimet e atakuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që për faktet vendimtare ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimeve lidhur me përmbajtjen e shkresave ose procesverbaleve.

Këto kundërthënie qëndrojnë në faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është anuluar nga gjykata e shkallës së dytë dhe është kthyer në rigjykim dhe rivendosje duke konstatuar se në këtë çështje penale duhet të bëhet super ekspertizë e komunikacionit meqenëse në shkresat e çështjes kanë ekzistuar dy ekspertiza të ekspertëve të komunikacionit të cilat kanë qenë kontradiktore dhe sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit është dashur që “pas marrjes së ekspertizës të shërbehën të gjitha palët në procedurë, t'u jepet mundësia që palët të cilat kanë interesat të parashtrojnë pyetje të njëjtat t'i parashtrojnë, të procedohen edhe të gjitha provat tjera në kuptim të dispozitave përkatëse ligjore”, duke u bazuar në këto vërejtje super ekspertiza i është dorëzuar mbrojtësit të të dënuarit, av. A.A., në seancën e datës 23.6.2016, ku nga ky procesverbal shihet se të njëjtit nuk i është dhënë mundësia dhe nuk është deklaruar fare as mbrojtësi e as i dënuari lidhur me të njëjtën. Po ashtu, në kërkesë pretendohet se i dënuari në seancën e datës 27.10.2016 ka deklaruar se nuk dëshiron të vazhdojë

shqyrtimin gjyqësor pa prezencën e avokatit mbrojtës dhe se gjykata në po të njëjtën seancë duke mos marrë kurrfarë aktvendimi formal i cakton avokatë sipas detyrës zyrtare të cilit nuk i dorëzohen shkresat e lëndës dhe nuk i jepet kohë për përgatitjen e mbrojtjes. Të gjitha këto konsiderohen si shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale nga neni 384 al.1 pika 1.12 të KPPK.

Sa i përket shkeljeve të ligjit penal në kërkesë konsiderohet se gjykata fare nuk ka analizuar kontributin në aksident të të dënuarit, mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur aksidenti dhe në rastin konkret këto janë elemente të rëndësisë së veçantë që është dashur të trajtohen e sidomos me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, sikur edhe rrethanat tjera si fakti se i dënuari është mbajtës i familjes, nuk ka ra në kundërshtim me ligjin se është pajtuar me familjen e të dëmtuarës.

Gjykata Supreme e Kosovës, nga shkresat e lëndës gjen se i dënuari me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është shpallur fajtor për veprën penale rrezikim i trafikut nga neni nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPK, dhe se ky aktgjykim nga Gjykata e Apelit të Kosovës është anuluar për shkak të faktit se në shkresat e lëndës kanë ekzistuar dy ekspertiza kontradiktore sa i përket kontributit të të dënuarit dhe pjesëmarrësit të tjerë në komunikacion lidhur me përgjegjësinë penale të tyre, andaj edhe është urdhëruar që në rigjykim të bëhet një super ekspertizë nga institucioni kompetent. Gjykata e shkallës së parë në rigjykim ka evituar këtë shkelje duke urdhëruar institucionin kompetent që të bëjë një super ekspertizë dhe kjo super ekspertizë i është dorëzuar palëve-mbrojtëses dhe të dënuarit që të njëjtit të përgatiten për shqyrtim kryesor dhe kjo është konstatuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor P.nr.11/2016 datë 23.6.2016, ndërkaq nga shkresat e çështjes nuk mund të konstatohet se Gjykata e Apelit ka urdhëruar gjykatën e shkallës së parë që t'i ftoj në seancën ekspertët e komunikacionit të cilët kanë dhënë mendimin e tyre në super ekspertizë. Në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 27.10.2016 kur edhe është lexuar ekspertiza e lart cekur e datës 12.5.2016 as mbrojtësja e as i dënuari nuk kanë kërkuar që ekspertët të ftohen dhe të dëgjohen në cilësi të ekspertit që këtë pretendim e bënë të pabazë.

Në të njëjtin procesverbal të datës 27.10.2016 vërtetohet se i dënuari sipas dispozitave të KPPK-së është udhëzuar për të drejtat e tij ,në mes të tjerave edhe për të drejtën në mbrojtje dhe është deklaruar se “dëshiron të deklarohet për çështjen e tij, nëpërmjet mbrojtësit sipas detyrës zyrtare av. M.D. ”që e bënë edhe këtë pretendim të pabazë, ngase i dënuari ka pas mbrojtje profesionale, dhe mbrojtësi nuk ka kërkuar kohë shtesë për përgatitjen e mbrojtjes.

Pretendimi se ndaj të dënuarit është bërë shkelja e ligjit penal meqenëse nuk është vlerësuar kontributi i tij në aksidentin për të cilin është shpallur fajtor po ashtu nuk qëndron sepse gjykata e shkallës së dytë – Gjykata e Apelit në aktgjykimin

PA.1nr.1595/2016 datë 21.2.2017, me rastin e vlerësimit të vendimit mbi dënimin mu për këtë arsye ka ndryshuar vendimin mbi dënimin duke gjet si rrethanë lehtësuese për të dënuarin, faktin se vozitësi i kombit nga i cili ka zbritur e ndjera para se të ndodhë aksidenti ka përgjegjësi sekondare. Gjykata e shkallës së parë i ka marrë të gjitha rrethanat e cekura si rrethana lehtësuese të cilat kanë ndikua me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ,që po ashtu e bënë edhe këtë pretendim të pabazë.

Andaj, Gjykata Supreme nuk i aprovoi as pretendimet në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkeljen e ligjit penal në dëm të të dënuarit.

Nga këto arsye e konform nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË  
PML.nr.82/2017, më 23 janar 2017

Procesmbajtësja  
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetar e kolegjit,  
Emine Mustafa